

FJALA E DEPUTETIT GAZMENT BARDHI

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

Të nderuar qytetarë,

Në 24 orët e fundit në këtë parlament është folur shumë për efektet që do të kenë në ekonominë e familjeve tuaja vendimet e qeverisë me paktën fiskale dhe buxhetin e vitit të ardhshëm. Nuk kemi pse ngatërrohem me shumë shifra. Nuk ka nevojë për të qenë ekonomistë, për të kuptuar nëse një paktë fiskale apo një buxhet është i mirë apo i keq për qytetarët. Të dashur qytetarë, Shikoni raftet e ushqimeve në shtëpitë tuaja, shikoni në frigoriferin tuaj nëse keni më shumë, atëherë kjo qeveri ka bërë një punë të mirë, por nëse keni më pak ushqime, nëse me të njëjtën shumë lekësh blini më pak gjëra dhe rroga juaj nuk ka ndryshuar, atëherë punët janë keq. Nuk ka asnjë dyshim që jemi në skenarin e dytë, çmimet janë rritur, njerëzit konsumojnë më pak. Është e qartë se punët janë keq dhe do të shkojnë akoma më keq për shumicën dërrmuese të shqiptarëve, sepse as buxheti, as paketa fiskale nuk punojnë për ta, por për një grusht njerëzish pranë Kryeministrit, punojnë për një grusht njerëzish që ndajnë paratë tona me ministrat dhe drejtorët e qeverisë së Edi Ramës. Qeveria do të rrisë taksat dhe përmes tyre do të rrisë çmimet për shqiptarët për të paguar koncesionet e reja dhe të vjetra, që nuk prodhojnë as vende pune, as zhvillim. Është një qeveri që thyen rekord kur vjen fjala për të zhvatur dhe për të plaçkitur njerëzit.

Nga njëra anë ka parashikuar të marrë vitin e ardhshëm rreth 1 miliard dollarë borxh dhe, nga ana tjetër, nuk ka asnjë rritje reale rrogash, pensionesh, nuk ka vende të reja pune, nuk ka investime domethënëse. Merr 1 miliard dollarë të tjera borxh për të paguar koncesionet. Për vitin e ardhshëm ka përfshirë në buxhet pagesën e 7 koncesioneve të reja, përveç atyre ekzistuese. Të shtata koncesionet, nga më të çuditshmet që keni dëgjuar ndonjëherë, do t'u kushtojnë shqiptarëve plot 2 miliardë dollarë. Të gjitha janë qepur dhe janë bërë gati për klientët e Edi Ramës. Koncesioni Milot-Fier është pazari më fitimprurës me 1,5 miliardë dollarë, koncesioni që mbikëqyr si bëhet kolaudimi i makinave nga qeveria është 170 milionë euro dhe, sigurisht, ka mbrapa një klient të qeverisë, përndryshe nuk do të ishte shpikur. Me borxhin e marrë vendosët për koncesionin e çuditshëm për sigurinë rrugore apo koncesionin delikat për sigurinë në rrjet për çelësat publikë. Edhe lulishtet, edhe fasadat e disa pallateve në qytetin e Elbasanit do të jepen me koncesion. Pasi e rrënuan qytetin dhe qarkun e Elbasanit, pasi nuk bënë asnjë investim për të qenë, sot do të japin me koncesion bojërat dhe barin e qytetit.

Koncesionet e shpikura për të zhvatur para, pa asnjë vlerë për ekonominë, janë tregues edhe se në thelbin e krizës në Shqipëri qëndron korrupsioni dhe paaftësia e kësaj qeverie. Për të paguar këto koncesione, vitin e ardhshëm do të dalin nga buxheti i shtetit plot 113 milionë euro. Sa para dalin për rritjen e pensioneve dhe të pagave për gati 1 milion shqiptarë? Janë vetëm rreth 50 milionë dollarë. Dhe diferenca është e qartë, por edhe e dhimbshme: për një grusht njerëzish mbi 100 milionë euro dhe për 1 milion shqiptarë vetëm 50 milionë euro, një fond qesharak, sepse në të vërtetë nuk ka as rritje reale pagash dhe as pensionesh, ka vetëm indeksim të inflacionit, për të mos thënë që ka ulje, po të llogarisim rritjen e inflacionit dhe të çmimeve. Rritja është më pak se 10 mijë lekë të vjetër në muaj për mësuesit, për mjekët dhe infermierët, më pak se 3 mijë lekë të vjetër për pensionistët; një tallje e dhimbshme. Dhe kjo ndodh, sepse Edi Rama nuk i ka shqiptarët në librin e llogarive të qeverisë. Kjo është një paketë fiskale që thëllon padrejtësisht hendekun e tmerrshëm mes një pakice, që qeveris dhe pasuron pa konkurrencë të ndershme, dhe shumicës dërrmuese të shqiptarëve. Kjo është një

paketë fiskale kundër shtresës së mesme. Në të gjithë botën qeveritë e qendrës së majtë dhe qendrës së djathtë krijojnë lehtësi për shtresën e mesme, por kjo nuk ndodh me qeverinë e Edi Ramës, sepse nuk kemi një qeveri të dalë nga një proces demokratik zgjedhor. 40% e të punësuarve në Shqipëri nuk do të kenë asnjë lehtësim nga taksat. Janë ata më të arsimuarit që gjykojnë dhe veprojnë në mënyrë të pavarur nga qeveria, janë profesionistë që paguhen nga 500 mijë deri në 1 milion lekë në muaj. Për qeverinë e Edi Ramës këta nuk ekzistojnë, sepse përgjithësisht këta nuk e votojnë. Edhe kur Edi Rama flet për zerimin e taksës për pagat deri në 400 mijë lekë apo për lehtësim të atyre deri në 500 mijë lekë në muaj, në të vërtetë nuk bën asnjë lehtësim. Me një rën dorë jep pak dhe me tjetrën merr shumë më shumë, sepse për vitin e ardhshëm kjo qeveri propozon rritjen e taksave për gazin. Për çdo litër gaz do të paguajmë 650 lekë më shumë taksë. Kjo do të rëndojë më shumë ata me pension apo me paga të ulëta, që gatuajnë dhe ngrohen me gaz.

Në fund të muajit do të dalin me minus, sepse nga 1 janari, për shkak të këtij vendimi që Edi Rama do të marrë sot, fatura e gazit vetëm për gatim dhe ngrohje, pa llogaritur përdorimin e makinave, do të jetë 15 mijë lekë deri në 20 mijë lekë më e shtrenjtë. Kurrë më parë njerëzit nuk kanë paguar kaq shumë për të blerë kaq pak. Kjo është pasojë direkte e keqqeverisjes, e vjedhjes dhe e zhvatjes. Prandaj Partia Demokratike do të votojë kundër paketës fiskale të Edi Ramës, kundër buxhetit të oligarkëve dhe klientëve të Edi Ramës. Kjo nuk është një votë kundër e opozitës thjesht për të votuar kundër qeverisë, është votë kundër marrjes peng të vendit për interesin e pak njerëzve, që janë pasuruar në mënyrë të paligjshme, duke zhvatur shqiptarët. Është një votë kundër, në emër të të gjithë shqiptarëve të ndershëm dhe punëtorë që nuk duan të ikin nga vendi dhe që përpiqen me të gjithë forcën për të ndërtuar këtu në Shqipëri një jetë dinjitoze. Është një votë kundër, në emër të të rinisë që do shkollim më të mirë dhe mundësi për punësim. Është një votë kundër, edhe në emër të prindërve tanë dhe pensionistëve që nuk panë asnjë ditë të bardhë në 8 vjet qeverisjeje të Edi Ramës. Kjo është një votë kundër borxhit që nuk është përdorur nga ky Kryeministër për të hapur vende të reja pune, nuk është përdorur për të mundësuar arsim më cilësor; nuk është përdorur për një sistem më të mirë shëndetësor.

Kjo qeveri ka marrë borxh, si askush tjetër më parë tre vjetët e fundit, 3 miliardë dollarë, por nuk ka bërë asgjë që u vlen shqiptarëve. Është qeveria më pa vizion dhe më pa ambicie për zhvillimin që ka pasur Shqipëria në 30 vjetët e fundit. Sot është dita që qeveria të ulë kokën, të kërkojë ndjesë dhe të ndryshojë politikën e saj të rrënimt të ekonomisë për pjesën më të madhe të familjeve të shqiptarëve. Mes oligarkëve dhe qytetarëve, qeveria gjithmonë do të duhet të zgjedhë qytetarët dhe t'u japë llogari pse nuk ka asnjë përgjigje për ata që luftojnë me inflacionin, me çmimet e rritura, me rritjen e taksave dhe me faturën e rritur të energjisë elektrike. Të nderuar qytetarë, Me këtë politikë që merr borxh për të larë borxh, pa hapur vende të reja pune, pa rritur pagat dhe pensionet, pa sjellë shpresë për rritjen e ekonomisë, mos u çudisni se nuk do të jetë e largët dita kur qeveria të kërkojë uljen e pagave, rritjen e fortë të taksave dhe rritjen e mëtejshme të çmimit të ujit dhe të dritave. Me bindjen se as fjalimet me premtime të bukura, por që nuk mbahen kurrë nga kjo qeveri, as postimet 3D në Facebook, nuk e ndryshojnë dot jetën tuaj për mirë, kam një apel për secilin prej jush: që jeta juaj të ndryshojë, që taksat tuaja të mos ngrihen, që të hapen vende të reja pune, që të luftojmë korrupsionin dhe të tërheqim investime të mëdha, na duhet të ndryshojmë qeverinë. Me këtë Kryeministër do të kemi të njëjtin rezultat si këta 8 vjet: oligarkët dhe klientët do të vazhdojnë të ndajnë miliona të pamërituara me qeverinë, ndërsa tjetër e qytetarëve do të vazhdojë të luftojnë për mbijetesë. Faleminderit!